

Vendim nr. 164 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (M) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: MIKEL FERKO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 18, datë 18.02.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë; nr. 108, datë 26.10.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë; nr. 00-2022-1740, datë 22.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Mikel Ferko është akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i të miturve” dhe “Falsifikimi i pasaportës”, të parashikuara respektivisht nga nenet 128/b, paragrafi 3 dhe 189, paragrafi 2, të Kodit Penal (KP), së bashku me disa shtetas të tjerë.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 18, datë 18.02.2016, për kërkuesin, ka vendosur: *“4. Deklarimin fajtor të të pandehurit Mikel Vexhi Ferko, për kryerjen e veprës penale të “Trafikimi i të miturve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 128/b, paragrafi i tretë i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Mikel Vexhi Ferko, për kryerjen e veprës penale të “Falsifikim i pasaportës”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga 189/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. Konform nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe caktimin e një dënimi të vetëm për të pandehurin Mikel Vexhi Ferko, prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjetësh burgim.”*. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe deklarimin të pafajshëm, pasi nuk provohet se ai e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 108, datë 26.10.2016, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 18 datë 18.02.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.”*. Kërkuesi ka paraqitur rekurs në datën 24.11.2016, duke kërkuar prishjen e dy vendimeve dhe pushimin e çështjes për veprën penale *“Trafikimi i të miturve”*, të parashikuar nga neni 128/b, paragrafi 3, i KP-së, pasi nuk vërtetohet fajësia e tij për këtë veprë dhe deklarimin fajtor vetëm për veprën penale *“Falsifikimi i pasaportës”*, të parashikuar nga neni 189, paragrafi 2, i KP-së.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1740, datë 22.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit kundër vendimit nr. 108, datë 26.10.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me argumentin se nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 24.04.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar në datën 10.05.2023, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

6.1. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë shkeljet e rënda procedurale dhe penale të gjykatave më të ulëta, si dhe pretendimet e paraqitura në rekurs. Ky standard është cenuar edhe nga gjykata e apelit, e cila nuk ka shqyrtuar pretendimet e tij gjatë procesit.

6.2. *Së drejtës për një gjykim të drejtë*, pasi gjykimi është zhvilluar mbështetur në prova të falsifikuara dhe mbi akte të cilat kanë ndikuar në cilësimin juridik të veprës penale, duke i rënduar atij pozitën si i pandehur. Viktima e veprës penale nuk ka qenë e mitur në kohën kur është kryer vepra penale, por as prokuroria dhe as gjykatat nuk e kanë verifikuar, si dhe nuk kanë hetuar për këtë fakt. Regjistrimi i saj në gjendjen civile është fiktiv dhe me të dhëna jo të sakta, si dhe ka kontradikta mes provave dhe fakteve. Pretendimet e kërkuarit nuk janë verifikuar dhe nuk janë marrë në konsideratë. Ekzistojnë dyshime të forta se viktima ka qenë e vitlindjes 1992 dhe jo si e kanë paraqitur gjykatat. Këto shkelje të lejuara në gjykatën e shkallës së parë nuk janë marrë në konsideratë as nga gjykata e apelit. Në vijim, edhe Gjykata e Lartë nuk ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe shkeljet ligjore procedurale në drejtim të cilësimit të drejtë të veprës penale, ku në kushtet e kundërshtimit për moshën e viktimës, çdo dyshim duhet të jetë në favor të të pandehurit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në këndvështrim të verifikimit të plotësisht të këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin janë marrë vendimet objekt kundërshtimi, si dhe është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta.

9. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha

mjetet juridike efektive. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 18 datë 04.04.2023; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit të zakonshëm. Në lidhje me pretendimet për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

11. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, vendimi gjyqësor i fundit i kundërshtuar nga kërkuesi mban datën 22.12.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual në Gjykatë është paraqitur fillimisht në datën 24.04.2023 (data e fundit për paraqitjen e ankimit 22.04.2023 ishte ditë e shtunë). Për rrjedhojë, kërkesa përmbush edhe kriterin e legjitimitimit *ratione temporis*.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, sipas jurisprudencës kushtetuese kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në këtë pikëpamje, për pretendimin për cenimin e së drejtës për një gjykim të drejtë kërkuesi ka pretenduar se gjykimi është zhvilluar mbështetur në prova të falsifikuara dhe mbi akte, të cilat kanë ndikuar në cilësimin juridik të veprës penale, duke i rënduar atij pozitën si i pandehur; viktima e veprës penale nuk ka qenë e mitur në kohën kur është kryer vepra penale, por as prokuroria dhe as gjykatat nuk e kanë verifikuar dhe nuk kanë hetuar për këtë fakt; regjistrimi i saj në gjendjen civile është fiktiv dhe me të dhëna jo të sakta, si dhe ka kontradikta mes provave dhe fakteve, të cilat nuk janë verifikuar nga gjykatat. Kolegji vëren se këto argumente kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe me interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë nuk do të trajtohen. Për sa i takon pretendimit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit, *prima facie* hyn në juridiksionin kushtetues dhe, si i tillë, do të analizohet vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit

14. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë shkeljet e rënda procedurale dhe penale të gjykatave më të ulëta dhe pretendimet e paraqitura në rekurs. Ky standard është cenuar edhe nga gjykata e apelit, e cila nuk ka shqyrtuar pretendimet e tij gjatë procesit.

15. Në lidhje me standardin e arsytimit, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale ose civile, si një garanci për procesin ligjor. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme ajo ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Gjykata verifikon nëse arsytimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 16 datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Duke verifikuar zbatimin e këtyre standardeve në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë fillimisht është ndalur në pretendimin kryesor të kërkuesit në lidhje me verifikimin e moshës së viktimës, e cila më tej ka qenë përcaktuese për cilësimin juridik të veprës penale. Kjo gjykatë ka vendosur të përsërisë shqyrtimin gjyqësor, duke urdhëruar marrjen e akteve që dokumentojnë regjistrimin e viktimës në gjendjen civile, si dhe çdo akt tjetër për vërtetimin e këtij fakti. Në përfundim të analizës së saj, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka arritur në përfundimin se viktima ka lindur në muajin mars të vitit 1993, duke e mbështetur arsytimin e saj në një sërë dokumentesh shkresore dhe pasi ka marrë në pyetje dëshmitarë të ndryshëm (*shih faqet 9-12 të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë*).

17. Në lidhje me respektimin e këtij standardi nga vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Kolegji çmon se ai përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs (*shih faqet 15-16 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ai mbështet qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk u referohen shkaqeve të rekursit të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, pasi nuk përbëjnë shkelje të ligjit

material ose procedural prej Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe kryesisht kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe provave në drejtim të kundërshtimit të provueshmërisë së akuzës. Ndërsa për pretendimet për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se ato nuk janë relevante as në lidhje me fazën procedurale ku ndodhet çështja dhe as me rolin e Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Gjithashtu, Kolegji Penal i ka kthyer përgjigje edhe pretendimit të kërkuarit për mungesën e arsytimit të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, duke e konsideruar të pabazuar, pasi kjo gjykatë ka arsyetuar në mënyrë ezauruese dhe u ka kthyer përgjigje pretendimeve të palëve (*shih paragrafët 31-33 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

18. Nga sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda plotësojnë kriteret e vendosura më sipër nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në ankim nga kërkuari, konkretisht ato që lidhen me vërtetësinë e moshës së viktimës, duke u kthyer përgjigje në thelb. Edhe Gjykata e Lartë, megjithëse me arsyetim të kufizuar, u ka kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuarit. Për sa i përket këtij arsytimi, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se ai nuk cenon standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.